



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 51, paragrafi 51.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d, dhe të nenit 44, paragrafi 44.1, pika a e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, të dispozitave të nenit 4 të Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110 - 273423, të dt. 09.12.2014, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 03.05.2018, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR FORMIMIN E**  
**KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

I. Miratohet Vendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si komitet i përhershëm, 01-020/05-15228/18, më 18.01.2018.

II. Pika II e vendimit të cekur në pikën I të këtij vendimi ndryshon dhe në te thuhet: Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, si në pikën I të këtij vendimi, ka këtë përbërje:

1. Agim Kuleta, LB, kryesues;
2. Eman Rrahmani, LVV, anëtar;
3. Genc Sherifi, Grupi i Pavarur, anëtar;
4. Egzon Azemi, LVV, anëtar;
5. Vala Peshku, Grupi i Pavarur, anëtare;
6. Halim Halimi, LDK, anëtar;
7. Agim Gashi, LDK, anëtar;
8. Jeta Rafuna, LDK, anëtare;
9. Blerand Stavileci, PDK, anëtar;
10. Fadil Gashi, AAK, anëtar;
11. Sami Boroci, AKR-AA, anëtar.

III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-020/04-0106715/18, më 07.05.2018



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta